



ShKÇAK  
DKRRK  
SCAAK



# STRATEGJIA E ZHVILLIMIT

2020 - 2024



## SHOQATA E KONTABILISTËVE TË ÇERTIFIKUAR DHE AUDITORËVE TË KOSOVËS (ShKÇAK)

ShKÇAK është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse, e themeluar në vitin 2001 me qëllim të zbatimit dhe promovimit të standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira për profesionin e kontabilitetit dhe auditimit, dhe asistimit në zhvillimin ekonomik në të mirë të interesit publik.

Me synim të plotësimit të nevojave të profesionistëve, ShKÇAK ofron programe certifikuese të cilësisë së lartë të cilat janë të njohura edhe nga tregu ndërkombëtar. Së fundmi, Shoqata ka filluar me ofrimin e programeve specializuese për anëtarët e saj në mënyrë që të plotësohen edhe kërkesat e reja që dalin nga një treg i cili është në zhvillim të vazhdueshëm.

Si organizata e parë profesionale e kontabilitetit dhe auditimit e licencuar nga Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF), ShKÇAK përfaqëson rreth shtatë mijë profesionistë, të cilët janë të angazhuar në sektorë të ndryshëm, në institucione kyçe të Republikës së Kosovës, siç janë Zyra e Kryeministrit, Ministritë, Banka Qendrore, Zyra Kombëtare e Auditimit, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, Komunitat si dhe bizneset dhe firmat e auditimit.

Si e vetmja shoqatë profesionale nga Kosova që është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK), Federatës Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM (EFAA) Federatës Mesdhetare të Kontabilistëve (FCM), pjesë e Komisionit të FNK-së për Zhvillim të Organizatave Profesionale të Kontabilitetit dhe Auditimit (PAODC) dhe Panelit Këshillues të FNK mbi Pajtueshmëri, dhe pjesë e Grupeve të Ekspertëve për Kontabilitet dhe Auditim të EFAA-së, Shoqata përfaqëson zërin e profesionistëve të Kosovës në këto organizata globale standard-vënëse dhe luan rol aktiv në zhvillimet globale të profesionit.





Ky dokument paraqet Strategjinë e ShKÇAK për periudhën 2020 – 2024 dhe është përpiluar duke u bazuar në misionin dhe vizionin e Shoqatës, ndikimin e Shoqatës në shoqëri, ambientin në të cilin vepron Shoqata dhe trendet e fundit që ndikojnë profesionin e kontabilitetit dhe auditimit.

Strategjia paraprake e ShKÇAK për periudhën 2015-2019 e cila është realizuar plotësisht, ka patur në fokus ngritjen e reputacionit të profesionistëve të sektorit privat, zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm të Sigurimit të Cilësisë, ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve në sektorin publik, dhe ofrimin e trajnimeve të specializuara në lëmitë relevante të profesionit të kontabilitetit dhe auditimit.

Me arritjen e objektivave të strategjisë paraprake, synimi i ShKÇAK për periudhën e ardhshme pesë vjeçare është të avancojmë profesionin që t'i shërbejë më së miri interesit publik. Ne besojmë që një komunitet i edukuar mirë, me parimet më të larta të etikës personale dhe profesionale i shërbenë kësaj aspirote. Për të arritur këtë, strategjia jonë e ardhshme fokusohet në tre shtylla:

1

**ZHVILLIMI I PROFESIONISTËVE TË SË ARDHMES**

2

**OFRIMI I VLERËS PËR ANËTARËT**

3

**QENDËR E EKSELENCËS PËR ZHVILLIM**

## DEKLARATAT QEVERISËSE

### MISIONI

*Të fuqizojmë profesionin e kontabilitetit dhe auditimit [në sektorin privat dhe publik] në Kosovë dhe regjion duke promovuar standardet më të larta të etikës, edukimit, dhe ekselencës profesionale për të mirën e shoqërisë si përfitues i fundit.*

### VIZIONI

*Shoqatë lidere në avancimin e profesionit të kontabilitetit, auditimit dhe shërbimeve tjera të specializuara duke ofruar gjithmonë zgjedhjen më të mirë për profesionistët.*

### QËLLIMI

*Zhvillimi i vazhdueshëm i programit të trajnimit i krahasueshëm me programet e shoqatave profesionale më eminente të kontabilitetit. Zhvillimi dhe avancimi i bazës së anëtarësisë të njohur për ekspertizë profesionale dhe standarde të larta etike. Anëtarësimi në organizata profesionale ndërkombëtare.*

### VLERAT

**Integriteti** – Ne jemi të përkushtuar të ruajmë standardet më të larta etike dhe profesionale për të siguruar besim dhe kredibilitet me kolegët tanë, anëtarët dhe publikun. Ne i trajtojmë njerëzit në mënyrë të drejtë, dhe presim të njëjtën nga të tjerët.

**Llogaridhënia** – Ne ofrojmë llogari për veprimet tona gjatë punës sonë.


**Kurioziteti** – Ne demonstrojmë një përpjekje të palodhur për dije dhe njohuri në kërkim të përsosmërisë profesionale.

**Mundësitë e barabarta** – Ne ofrojmë mundësi të barabarta për njerëzit tonë, nëse janë student, anëtarë apo punonjës ne i mbështesim ata në çdo fazë të karrierës së tyre.

**Diversiteti** – ne respektojmë dhe vlerësojmë dallimet, mbështesim diversitetin tek stafi ynë, anëtarët dhe bashkëpunëtorët.

**Kualiteti** – Atë që ne e bëjmë, e bëjmë mire dhe me cilësi.

## NDIKIMI YNË NË SHOQËRI



## TRENDET SHOQËRORE EKONOMIKE GLOBALE

ShKÇAK vepron në një mjedis i cili është vazhdimisht i ndryshueshëm dhe nuk mund të parashikohet lehtë. Strategjia 2020-2024 është zhvilluar duke marrë parasysh trendet e fundit shoqërore dhe ekonomike si në Kosovë ashtu edhe në botë.

Ndryshimet e shpeshta në politikat shtetërore dhe qasjet e politik-bërësve

Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë dhe ndikimi i saj në të bërit biznes

Liberalizimi potencial i vizave dhe largimi i të rinjve nga Kosova

Ndikimi i inovacioneve në mënyrën së si funksionojnë tregjet

Mundësia e të mësuarit nga distanca (Distance Learning) dhe ndikimi në metodat tradicionale të mësimdhënies

Humbja e vazhdueshme e besimit në udhëheqësit dhe institucionet shtetërore

Qasja e gjeneratave të reja ndaj punësimit dhe kushteve tradicionale të punës

Popullsia e moshuar në vendet e zhvilluara dhe popullsia e re në vendet në zhvillim

Papunësia dhe mungesa e fuqisë punëtorë me aftësi të kërkuara nga punëdhënësit

Konkurrenca gjithnjë e në rritje si rezultat i globalizimit të vazhdueshëm të tregut të punës

## TRENDET NË PROFESIONIN E KONTABILITETIT DHE AUDITIMIT

Ndryshimet në ambientin ku kontabilistët dhe auditorët veprojnë po sjellin edhe ndryshime në mënyrën e ushtrimit të këtij profesioni. Strategjia e ShKÇAK 2020-2024 merr parasysh këto trende në mënyrë që Shoqata të jetë gjithmonë në mbështetje të anëtarëve të saj.

Teknologjitë e reja dhe fokusi i vazhdueshëm në inkorporimin e tyre në procese të punës, kërkojnë që kontabilistët dhe auditorët të kenë aftësi dhe kapacitete më të zgjeruara

Kërkesat gjithmonë e në rritje nga rregullatorët dhe ngarkesat që këto kërkesa shkaktajnë tek auditorët

Fokusi i rritur në cilësinë e auditimeve dhe pritjet gjithnjë e më të mëdha nga auditorët

Ndryshimi i perceptimit të publikut mbi profesionin e kontabilitetit dhe auditimit

Ngritja e vetëdijes mbi rëndësinë e etikës dhe qeverisjes së mirë

Kërkesat për raportim më gjithëpërfshirës të kompanive, për dallim nga raportimi tradicional i fokusuar në informata financiare

## OBJEKTIVI 1: ZHVILLIMI I PROFESIONISTËVE TË SË ARDHMES

Edukimi është bazë për kompetencat profesionale. Ne zhvillojmë profesionistët e së ardhmes përmes programeve tona të cilësisë së lartë që kërkojnë zbatimin e njohurive teknike dhe një kornizë etike për t'i shërbyer atyre në profesionet e tyre gjatë vendim marrjes. Profesionistët e së ardhmes paraqesin të dyja: të ardhmen e anëtarëve tonë ekzistues dhe gjeneratat e ardhshme të profesionistëve.

### **Avancimi i profesionalizmit dhe thirrjes profesionale**

Për të qenë lider në profesionin e kontabilitetit, auditimit dhe shërbimeve të specializuara, është qenësore që ne të bindim industrinë e ndryshme, rregullatorët dhe praktikuesit e profesionit që të kuptojnë rëndësinë e profesionalizmit dhe t'i përmbahen parimeve të saj. Ne besojmë që fuqizimi i thirrjes profesionale është tejet i rëndësishëm në avancimin e misionit të shoqatës dhe përmirësimit të praktikës profesionale të anëtarëve tanë. Ne synojmë të punojmë ngushtë me udhëheqësit e industrive për të kuptuar më për së afërmi aftësitë dhe kompetencat që nevojiten për të qenë në gjendje të përballojnë ndryshimet në industri dhe ambientin biznesor. Ne do të përdorim qasje që ne kemi qoftë tek udhëheqësit e kompanive apo ata në sektorin publik përmes anëtarëve tanë për të theksuar nevojën për profesionalizëm dhe thirrje profesionale. Një mënyrë e mirë për të iniciuar diskutime me anëtarët tonë për çështjet që ata i preokupojnë është Forumi i SHKÇAK-ut. Ne synojmë të shtojmë prezencën tonë në Forum por edhe një prezencë dhe angazhim më të madh të anëtarëve tonë.

### **Transformimi digjital**

Revolucioni digjital pritet të sjell ndryshime të mëdha tek të gjitha kompanitë pavarësisht madhësisë. Përveç ndryshimit në modelet e biznesit, digjitalizimi do të prek edhe funksionet mbështetëse si kontabilitetin, kontrollin e brendshme dhe menaxhmentin. Ne e shohim teknologjinë si mjet lehtësues për të arritur një qëllim dhe për ndryshim, e jo si zgjidhje magjike. Përpjekjet tona në këtë drejtim do të jenë të dyfishta. Në njërin anë ne synojmë të jemi në hap me ndryshimet teknologjike dhe të përcjellim ndryshimet që digjitalizimi do të sjell tek sistemet e kontabilitetit, auditimit dhe shërbimeve tjera të specializuara për të ofruar programe dhe trajnime që i pajisin anëtarët me aftësitë dhe shkathtësitë e nevojshme.

Në anën tjetër, ne synojmë që të përdorim teknologjinë digjitale për të krijuar platforma që na lejojnë të ofrojmë përmbajtje më të madhe, forcojmë komunitetin tonë profesional, dhe të mirëmbajmë programe relevante për anëtarët. Ne do të zhvillojmë e-platforma të cilat do të na mundësojnë të konvertojmë përmbajtjen ekzistuese në mësim dhe vlerësim online, dhe digjitalizojmë proceset tona të punës përfshirë formularët, aplikacionet etj. Ne do të zhvillojmë plane të detajuara si të përdorim teknologjinë informative dhe platformat e teknologjisë informative në ofrimin e programeve dhe produkteve tona.



## OBJEKTIVI 2: OFRIMI I VLERËS PËR ANËTARËT

Si një shoqatë që ka në qendër të vëmendjes anëtarin e saj, ne i pajisim dhe mbështesim anëtarët tonë me të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë që ata t'i shërbejnë klientët e tyre më së miri dhe që të avancojnë karrierën e tyre profesionale. Kjo arrihet përmes një komuniteti aktiv profesional, duke krijuar dhe ofruar zhvillim të vazhdueshëm profesional, ndërlikime ndërmjet punëdhënësve dhe anëtarëve dhe ngjarjeve promovuese profesionale.

### **Kritja, angazhimi, dhe ruajtja e anëtarëve**

SHKÇAK ndihmon anëtarët e saj për t'u bërë më të suksesshëm në profesionin e tyre dhe ofron përfitime të prekshme për anëtarët me një kosto të arsyeshme. Ne besojmë që qëndrueshmëria afatgjate e Shoqatës varet nga mënyra efektive e përmbushjes së nevojave të anëtarëve tanë.. Për këtë qëllim një pjesë e mirë e stafit të shoqatës është e angazhuar në kuptimin, krijimin dhe ofrimin e vlerës për anëtarët me synimin që të zgjerojmë anëtarësinë dhe të rrisim angazhimin e anëtarëve tanë. Përveç aktiviteteve aktuale që përfshijnë njoftimin e anëtarësisë për zhvillime që ndikojnë profesionin e tyre, ne synojmë të zgjerojmë aktivitetet që shtojnë vlerë për anëtarët duke i vetëdijësuar bizneset dhe institucioniet për përfitimet që sjellë cilësia e punës së anëtarëve dhe shërbimeve që ata ofrojnë.

### **Edukimi i Vazhdueshëm Profesional (EVP)**

Që të përfitoj shoqëria përmes rezultateve të përmirësuara në punë, profesionistët duhet të mbështeten nga një kulturë të bazuar në kompetenca që nënvizon parimet e duhura etike dhe vendos interesin e klientëve ose organizatave përpara interesit personal. Çdo profesion bartë një përgjegjësi profesionale. Një aspekt shumë i rëndësishëm i kësaj është që praktikuesit e profesionit të kontabilitetit, auditimit dhe shërbimeve të specializuara, punëdhënësit, punonjësit, dhe publiku i gjerë të kuptojnë rëndësinë që bartë kjo përgjegjësi profesionale. Çdo profesion kërkon që praktikuesit e atij profesioni përveç që duhet të jenë të pajisur me njohuritë themelore të profesionit, të jenë të përkushtuar ndaj tij dhe të zbatojnë një kornizë etikës ata gjithashtu duhet që vazhdimisht të demonstrojnë një zhvillim të vazhdueshëm profesional. Ne gjithashtu do të përmirësojmë mekanizmat ekzistues për demonstrimin e plotësisht të kërkesave për zhvillim të vazhdueshëm profesional duke krijuar vegla elektronike të regjistrimit dhe raportimit të EVP.

## **Ndërgjegjësimi mbi reputacionin e SHKÇAK**

Reputacioni ynë ka qenë qenësor për të arritur deri këtu. Mirëmbajtja e reputacionit të SHKÇAK-së vazhdimisht ka qenë dhe mbetet një nga mënyrat për të rritur vlerën për anëtarët. Për shkak se shumë lehtë reputacioni i Shoqatës mund të ndikohet nga zhvillimet dhe gjendja e shoqatës, ne do t'i kushtojmë rëndësi të veçante investimit në promovimin dhe mbrojtjen e reputacionit dhe kjo do të jetë një ndër fokuset e kësaj strategjie. Ne do të kërkojmë tek të gjithë anëtarët tanë që të bëjnë veprime që rrisin ndërgjegjshmërinë për reputacionin e “SHKÇAK” (p.sh një mënyrë është inkurajimit i përdorimit të shkronjave SHKÇAK pas emrit të tyre qoftë në profilet e LinkedIn ose në rezymetë e tyre).

## **Shërbime cilësore ndaj anëtarëve**

ShKÇAK do të angazhohet që të ofrojë shërbime që paraqesin vlerë të shtuar për anëtarin e saj siç është sigurimi që shërbimet e anëtarëve janë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ne do të avancojmë sistemin e sigurimit të cilësisë për auditorët ligjorë, dhe do të dizajnojmë, zhvillojmë dhe implementojmë sistemin e sigurimit të cilësisë edhe për kontabilistët. Gjithashtu, ne do të avancojmë EVP-të në funksion të nevojave që dalin nga sistemi i sigurimit të cilësisë për anëtarët tanë. ShKÇAK do të vazhdojë të bashkëpunojë dhe mbajë kontaktet e vazhdueshme me rregullatorët dhe palët e tjera.

## OBJEKTIVA 3: QENDËR E EKSELENCËS PËR ZHVILLIM

Si një organizatë profesionale e zhvilluar në një vend në tranzicion e cila shpesh herë merret si shembull i mirë nga FNK në udhëzues për qeverisjen e organizatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit dhe udhëzues të tjerë, ShKÇAK synon të shërbejë si Qendër e Ekselencës për të ndihmuar organizatat tjera në vendet në zhvillim.

### **Qendra për Hulumtim dhe Konsulencë (QHK)**

Ne synojmë që të themelojmë një Qendër të Hulumtimit dhe Konsulencës brenda SHKÇAK që do të shërbejë si një qendër kombëtare dhe ndërkombëtare për shërbime këshillëdhënëse. Po ashtu kjo do të shërbejë edhe si qendër për hulumtim në fushat kryesore tematike veçanërisht në çështje që kanë të bëjnë me qeverisje korporative dhe menaxhimin financiar në sektorin publik dhe privat mirëpo edhe hulumtime të personalizuar sipas nevojës së organizatave të sektorit publik apo privat.

### **Forcimi i ekselencës operacionale**

Ne besojmë që për të qenë në gjendje të zbatojmë strategjinë tonë dhe të avancojmë misionin e SHKÇAK-së, ne kemi nevojë të forcojmë operacionet dhe kapacitetet tona të brendshme. Ne vazhdimisht do të fokusohemi të investojmë në zhvillimin e kapaciteteve tonë, proceseve, dhe teknologjisë.

### **Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar**

Ne synojmë të vazhdojmë forcimin e bashkëpunimit tonë rajonal dhe ndërkombëtar me organizatat partnere për të krijuar ose fuqizuar ekspertizën teknike, leadershipin, qeverisjen dhe strategjitë, kualifikimet profesionale dhe trajnimet vendore sipas standardeve ndërkombëtare dhe kulturën e zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Ne duam që të thirremi në përvojën tonë të gjatë dhe suksesshme në krijimin e organizatave profesionale për të ndihmuar organizatat tjera në ndërtimin e kapaciteteve të brendshme në funksionet kryesore si në financa, burime njerëzore, edukimi, administrata, mbështetja në zhvillim të menaxhmentit, vlerësimit dhe kulturës organizative. Po ashtu ne duam të ofrojmë ekspertizën tonë në krijimin e sistemeve për sigurimin e cilësisë, shkëmbejmë përvojat rreth manualeve, dokumenteve, procedurave dhe udhëzuesve për shoqatat tjera.

### **Zhvillimi strategjik**

Gjatë periudhës së Strategjisë së kaluar (2015-2019) ne kemi përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme kapacitetin tonë të zhvillimit strategjik. Ne synojmë të avancojmë edhe më tutje kapacitetet tona të brendshme për zhvillim strategjik përmes krijimit të një ekipi për Strategjinë e Zhvillimit, që do të kryesohet nga Drejtori Ekzekutiv. Ekipi do të jetë përgjegjës që të shqyrtojë rregullisht punën tonë organizative dhe raportimin e progresit (p.sh përmes raportit tonë vjetor të punës).

## OBJEKTIVI 3: QENDËR E EKSELENCËS PËR ZHVILLIM

Gjatë periudhës së Strategjisë 2020-2024 ne synojmë që të rishikojmë në baza të rregullta progresin tonë në zbatimin e Strategjisë sonë për të parë se çfarë është arritur dhe për të azhurnuar planin tonë të veprimit sipas nevojës.

### **Struktura organizative dhe komisionet e SHKÇAK**

Ne gjithmonë do të rishikojmë strukturën tonë organizative e cila buron nga statuti i SHKÇAK si akti më i lartë i shkruar dhe do të eksplorojmë forma moderne qeverisjes për të shërbyer misionin tonë sa më mirë. Struktura jonë organizative dhe kapacitetet tona njerëzore janë esenciale në përmbushjen e kësaj objective strategjike. Ne kemi krijuar një sërë komisionesh me përgjegjësi të definuara mirë të cilat janë pjesë përbërëse e strukturës së SHKÇAK me qëllim të përkrahjes së implementimit të strategjisë sonë. Gjatë periudhës së strategjisë tonë, ne do të shikojmë nevojën për komisione të reja dhe do të eksplorojmë mundësitë se si të përmirësojmë edhe më tutje efektivitetin e komisioneve aktuale.

### **Qeverisja korporative brenda SHKÇAK**

Qeverisja korporative është sistemi me të cilin drejtohen, kontrollohen dhe udhëhiqen organizatat. Një strukturë e mirë korporative vendos marrëdhëniet dhe mënyrën se si të drejtat dhe përgjegjësitë shpërndahen ndërmjet atyre që punojnë në organizatë dhe palëve të jashtme, po ashtu vendos mënyrat se si organizatat i vendosin objektivat, mjetet për arritjen e këtyre objektivave dhe monitorimin e performancës. Për të dhënë këshilla mbi qeverisjen korporative dhe parimet etike, është tejet e rëndësishme që ne vazhdimisht të forcojmë aranzhimet tona të qeverisjes korporative dhe të shërbejmë si shembull për organizatat tjera. Ne synojmë që gjatë periudhës së strategjisë tonë edhe më tutje të forcojmë këto aranzhime të qeverisjes organizative dhe të paraqesim forma dhe masa të reja që do të përmirësojnë edhe më tutje qeverisjen tonë.

### **Njerëzit tonë**

Njerëzit tonë janë zemra e shoqatës. Qëllimi ynë është të tërheqim, mbajmë dhe zhvillojmë një ekip të mirë të njerëzve të cilët tek ne nuk do të gjejnë thjeshtë një vend pune mirëpo, një mundësi për karrierë dhe zhvillim. Është shumë e rëndësishme që ne të kemi sisteme të mira të menaxhimit të burimeve njerëzore për të nxjerrë më të mirën prej tyre. Ne do të vazhdojmë të përmirësojmë edhe më tutje politikatat dhe procedurat tona të burimeve njerëzore dhe sistemet përkatëse. Element kyç do të jenë politikatat ndaj rekrutimit, menaxhimit të performancës dhe trajnimit dhe zhvillimit.

### STRENGTHS/PËRPARËSITË

- Lidere në treg
- Njohja globale - Anëtare e plotë në IFAC, FCM dhe EFAA
- Staf Profesional dhe të Motivuar
- Qeverisje e mirë
- Reputacion i lartë
- Bashkëpunimi me palët e interesit

### WEAKNESSES/DOBËSITË

- Qëndrueshmëria financiare nga të hyrat e anëtarësisë
- Mungesë e stafit (pasojë e mungesës së fondeve)

### OPPORTUNITIES/MUNDËSITË

- Pozitë dominuese
- Depërtimi / kycja në sektorin publik
- Zhvillimi specializimeve / çertifikimeve të tjera
- Qendër rajonale e Ekselencës

### THREATS/RREZIQET

- Korniza ligjore në Kosovë
- Ambienti i përgjithshëm - mosfunksionimi/moszbatimi i ligjit
- Konkurrenca jo lojale
- Mungesa e fondeve të brendshme dhe nga donatorët për zhvillime të programeve të reja
- Vullneti politik në lidhje me reformën e raportimit financiar

## PËRFUNDIM

Strategjia 2020-2024 do të jetë udhërrëfyes i ShKÇAK përgjatë pesë viteve të ardhshme. Shoqata do të jetë e përkushtuar në përmbushjen e objektivave të kësaj strategjie nga e cila do të përpilohen edhe planet vjetore të punës.

Për t'i arritur të gjitha objektivat, ShKÇAK e konsideron tejet të nevojshëm bashkëpunimin me anëtarët e saj, Këshillin, Komisionet dhe të gjitha palët e tjera me interesa të përbashkëta.

Periodikisht, Shoqata do të vlerësojë nevojën e rishikimit të kësaj strategjie varësisht nga ndryshimet që mund të ndodhin në ambientin në të cilin ShKÇAK vepron si nga aspekti ligjor, politik dhe ekonomik.

